



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 14
Prishtinë, më 29.06.2012, në orën 13.30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj, Biserka Kostiq, Kurtan Kajtazi, Albana Gashi, Kimete Bytyçi dhe Kymete Bajraktari.

Munguan: Justina Pula dhe Duda Balje.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Të ftuar: Mahir Yagcilar, ministër i Administratës Publike dhe Sami Kurteshi, Avokat i Popullit.

Pjesëmarrës të tjerë: **Shqipe Ibraj-IAP; Irfan Kastrati -drejtor ekzekutiv IAP; Ergin Kala- këshilltar i ministrit të MAP-it; Mergim Lushtaku-DIEKP-MAPE**Elita Vokshi-OSBE; Nevahir Hazeri-KDI; Floriana Shala-OSBE; Ukë Gashi-ZPRK; Visar Bivolaku-EU, OFFICE-EUSR; Nuredin Ibishi- CDF; Burim Tahiri.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura, më 8 dhe 12 qershor 2012;
3. Takim me z. Mahir Yagcilar, ministër i Administratës Publike dhe Avokatin e Popullit, rreth shqyrtimit të pikës (19.1) të Planit të Veprimit nga ora 13:10;

4. Takim me z. Enver Hoxhaj, ministër i Punëve të Jashtme, rreth pikës 74 të Planit të Veprimit nga ora 13:40;
5. Njoftim me raportin e MPMS-së rreth pikës 53.2 dhe 54 të Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian;
6. Rishqyrtimi i vendimit të Komisionit lidhur me caktimin e personave për monitorimin e ligjeve;
7. Të ndryshme.

Kryetarja – E njoftoi Komisionin se në këtë mbledhje nuk do të marrë pjesë ministri Enver Hoxhaj, prandaj i njëjti do të ftohet në mbledhjen e ardhshme.

Komisioni vendosi që të fillohet me pikën e tretë të rendit të ditës, për shkak të kohës, pasi që ministri është i zënë me punë të tjera.

Kryetarja- Konstatoi se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes së Komisionit.

3. Takim me z. Mahir Yagcilar, ministër i Administratës Publike dhe Avokatin e Popullit, rreth shqyrtimit të pikës (19.1) të Planit të Veprimit nga ora 13:10

Kryetarja- Tha se qëllimi i këtij takimi të përbashkët me ministrin e Administratës Publike dhe Avokatin e Popullit është që të konstatohet se a janë përmbushur pikat e Planit të Veprimit për vitin 2012.

Në vazhdim, ajo tha se Komisioni është i njoftuar me kërkesat e IAP-it, me të cilat po ballafaqohet me mungesën e objekteve, si dhe sfida të tjera, prandaj e kemi ftuar ministrin Yagcilar, që ta informojë Komisionin se çka ka ndërmarrë për zgjedhjen e problemeve të IAP-it. Ajo e ftoi ministrin që ta marrë fjalën.

Z. Mahir Yagcilar, ministër- Përsëritësi të pranishmit dhe shtoi:

“Ministria, Komisionit ia ka dërguar raportin dhe e ka njoftuar me veprimet e ndërmarra për zgjidhjen e këtyre çështjeve që u theksuan më lart”.

Ai më tutje shtoi se Ministria e ka shikuar kornizën afatmesme të shpenzimeve për vitin 2013 dhe mendon se do të kërkojnë mjete buxhetore, por më parë kërkohet të caktohet lokacioni i ndërtimit, e pastaj do t’i rendisim punët në pajtueshmëri me kompetencat që i ka kjo Ministria. Ai i njoftoi anëtarët e Komisionit, në vija të trasha, rreth ndërtimit të objekteve, siç janë: objekti i Pallatit të Drejtësisë, objekti i FSK-së, si dhe objekte të tjera. Sipas tij, në vitin 2014 është paraparë ndërtimi i ndërtesës së IAP-it.

Pas fjalës së tij, kryetarja i ftoi anëtarët e Komisionit që t’u parashtrojnë pyetje mysafirëve prezentë.

Suzan Novoberdali (kryetare) - Duke u ndërlidhur me diskutimin e ministrit, kërkoi sqarim se kërkesat e theksuara më lart, a janë më të rëndësishme sesa kërkesat e IAP-it. Gjithashtu, kërkoi sqarim se problemet e hapësirave të IAP-it nuk do të zgjidhen së paku edhe dy vite.

Mahir Yagcilar- Sa i përket pyetjes së parafolësës, theksoi se me ndërtimin e Pallatit të Drejtësisë do të lirohen shumë ndërtesa, por varet se a do të jenë të përshtatshme për punën e IAP-it.

Sami Kurteshi (IAP)- Duke u ndërlidhur me përgjigjen e ministrit, theksoi se IAP-i ka kërkuar në vitin 2009 dhe 2011, por nga Kuvendi i Kosovës ka marrë përgjigje se nuk bie në fushëveprimin e tij, duke udhëzuar që t'i drejtohet Ministrisë së Administratës Publike të Kosovës, e cila është përgjigjur se nuk ka mundësi në sigurimin e objektit. Ai tha se Avokati i Popullit, por edhe zyrat rajonale nuk janë në pozitë më të mirë se Avokati i Popullit.

Albana Gashi - Duke u ndërlidhur me parafolësit, kërkoi nga ministri Yagcilar dhe Avokati i Popullit të dijë se cilat janë prioritetet e tyre, meqë ky institucion është i vetmi në Kosovë që merret me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Avokati i popullit - Duke iu përgjigjur pyetjes së deputetes, theksoi se Institucioni i Avokatit të Popullit, si çdo institucion tjetër, duhet të ketë buxhetin dhe fushëveprimin, si dhe objektin përkatës ku ushtron veprimtarinë e vet.

Rita Hajzeraj- Kërkoi sqarim se a ekziston korniza e shpenzimeve për vitin 2013 në drejtim të ndarjes së buxhetit për ndërtimin e objektit, si dhe sigurimin e lokacionit. Ajo e sugjeroi ministrin se si Ministri mund të gjeni edhe donacione për ndërtimin e këtij objekti, i cili është shumë i rëndësishëm dhe pyeti se sa janë këto mundësi. Në fund, ajo kërkoi sqarim për nxjerrjen e ligjit të ri, i cili do të merrej me ndarjen e kompetencave.

Mahir Yagcilar- Ishte i mendimit se duhet të ekzistojë ligji përkatës, në mënyrë që mos të ketë përzierje të kompetencave në mes organeve shtetërore dhe institucioneve të pavarura, prandaj kjo çështje do të diskutohet në Kuvend lidhur me ndërtimin e objektit të IAP-it, para se të miratohet buxheti për vitin 2014.

Kymete Bajraktari- Duke u ndërlidhur me diskutimin e ministrit, kërkoi sqarim rreth disa ndërtesave të cilat janë liruar nga UNMIK-u, prandaj pyeti: Kush i menaxhon dhe kush vendos për shfrytëzimin e tyre dhe a ka kërkesa nga ana e IAP-it për t'i marrë në shfrytëzim?

Mahir Yagcilar-Duke u përgjigjur në pyetjen e deputetes, theksoi se nuk është shumë i informuar për këto ndërtesa, por ekziston Departamenti i Inxhinierisë dhe nuk di a ka pasur memorandum të pranimit dhe dorëzimit të tyre, por më kujtohet se kemi kërkuar nga UNMIK-u që të lirohen këto objekte.

Lidhur me këtë temë, bëri pyetje edhe kryetarja e Komisionit.

Kurtan Kajtazi -Tha se edhe ne si deputetë kemi mundësi të japim propozime për buxhetin e vitit 2013.

Ai i njoftoi të pranishmit se Komisionit është duke bërë monitorimin e Ligjit për Avokatin e Popullit, si dhe njoftoi për vizitat në disa zyra rajonale në komuna të ndryshme. Lidhur me këtë, ai tha se kemi hasur në kushte jo të mira pune, si dhe mungesën e lokaleve, prandaj do të ishte mirë që t'u rekomandohet komunave për ndarjen e hapësirave më të mira, sipas mundësive që ato kanë.

Kimete Bytyçi- Duke u ndërlidhur me parafolësit, shtori pyetjen: A keni marrë ndonjë përgjigje me shkrim rreth kërkesave të ushtruara nga ana e IAP-it?

Pastaj pyetje të tjera bënë edhe Albana Gashi dhe Suzan Novoberdali, të cilave iu përgjigjën Ministri dhe Avokati i Popullit.

2. Miratimi procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 8 dhe 12 qershor 2012.

Biserka Kostiq- Tha se ka vërejtje në procesverbalin e mbledhjes së 12 qershorit, ku ajo ka qenë në mbledhje, por në procesverbal është konstatuar se mungon.

Kryetarja- Kërkoj nga stafi mbështetës, që këto gabime të rregullohen dhe të mos përsëriten, prandaj Komisioni, me vërejtjet e theksuara më lart, miratoi procesverbalet e mbledhjeve 8 dhe 12 qershor 2012.

5. Njoftim me raportin e MPMS-së rreth pikës 53.2 dhe 54 të Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian

Kryetarja - Pasi i njoftoi anëtarët e Komisionit me raportin e Ministrisë, i cili me kohë u është shpërndarë anëtarëve të Komisionit, i kërkoj Komisionit që, pas një debati lidhur me këtë raport, të dilet me konkluzione, në mënyrë që të përfshihen ato në raportin kryesor, i cili do t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Lidhur me këtë pikë, ajo ftoi anëtarët që të marrin fjalën.

Rita Hajzeraj-Tha se Ministria duhet të japë raport më të detajuar.

Kryetarja- I kërkoj Komisionit që këtë pikë të rendit të ditës të shtyjë për një mbledhje tjetër, me qëllimin që të analizohet mirë dhe të dalim me rekomandimet e duhura. Komisioni, pasi e shqyrtoi propozimin e kryetares, mori qëndrim që e njëjta të hiqet nga rendi i ditës dhe në mbledhjen e radhës të vihet në shqyrtim.

6. Rishqyrtimi i vendimit të Komisionit lidhur me caktimin e personave për monitorimin e ligjeve

Kryetarja- I njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me caktimin e grupit të punës që ka për detyrë monitorimin e ligjeve, të cilat janë të përfshira edhe në Planin e punës së Komisionit.

Në vazhdim, ajo tha se jemi në proces të monitorimit të Ligjit për Avokatin e Popullit, Ligjin kundër diskriminimit, Ligjin për barazi gjinore dhe Ligjin për persona të zhdukur.

Mirëpo, anëtarja e Komisionit, Kimete Bytyçi ka shprehur pakënaqësinë lidhur me punën e Komisionit që nuk e ka përfshirë në asnjë grup të punës si anëtare e grupit.

Ajo i propozoi Komisionit që në atë grup të punës, ku është caktuar si anëtare, të zëvendësohet me deputeten Kimete Bytyçi.

Pas një diskutimi të gjerë dhe konstruktiv që u zhvillua lidhur me këtë pikë, Komisioni nxori unanimisht këtë

Përfundim

Komisioni e emëroi anëtare të grupit të punës, deputeten Kimete Bytyçi, e cila do të marrë pjesë në monitorimin ligjeve si vijon: në grupin e punës për monitorimin e Ligjit për persona të zhdukur, në grupin e punës për monitorimin e Ligjit për Avokatin e Popullit, në grupin e punës për monitorimin e Ligjit kundër diskriminimit dhe në grupin e punës për monitorimin e Ligjit për barazi gjinore.

6. Të ndryshme.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 15:10.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali